

Shoqata e kontabilistëve të çertifikuar dhe auditorëve të Kosovës

**LIGJET DHE TATIMET NË KOSOVË**

**(zgjidhjet)**

**P4**

Nr.

**FLETË PROVIMI**

**Udhëzime :**

1. MOS E HAPNI DERISA T'IU LEJOHET PREJ MBIKËQYRËSIT
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË KËTIJ PROVIMI.

Data 04.01.2017

1. Sipas Ligjit Për Shoqëritë Tregtare, shoqëria komandite, shoqëria me përgjegjësi të kufizuar dhe shoqëria aksionare mund të krijohen vetëm pas përfundimit të procedurës së regjistrimit në Zyrën e Regjistrimit sipas kushteve të parapara në këtë ligj.

**E saktë**

E pasaktë

2. Zyra e regjistrimit të Shoqërive Tregtare dhe Emrave Tregtar në Kosovë themelohet si një agjenci e pavarur ekzekutive në kuadër të Ministrisë së Financave.

E saktë

**E pasaktë**

3. Zyra e Regjistrimit duhet të ruajë përherë të gjitha shënimet dhe dokumentet, duke përfshirë dokumentet e pranuar ose të regjistruara.

**E saktë**

E pasaktë

4. Sipas Ligjit “Për Shoqëri Tregtare”, shoqëria e regjistruar tregtare ose shoqëria e huaj tregtare, por jo ndërmarrja individuale mund të shfrytëzojnë një emër tjetër tregtar i cili është i ndryshëm nga emri i regjistruar zyrtar.

**E saktë**

E pasaktë

5. Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar është përgjegjëse për të gjitha borxhet e saj dhe detyrimet tjera me tërë asetet duke përfshirë edhe kapitalin themeltar si dhe pasurin e vet pronareve të shoqërisë.

E saktë

**E pasaktë**

6. Sipas Ligjit "Për Shoqëri Tregtare", shoqëria duhet të ketë medoemos aksione të thjeshta dhe duhet të emetojë së paku një aksion të thjeshtë

**E saktë**

E pasaktë

7. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim Shoqëritë tregtare me rastin e përgatitjeve të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme, aplikojnë standardet e kontabilitetit, rregulloret dhe udhëzimet administrative të lëshuara nga KKRF-ja sipas nenit të 5 të këtij ligj

**E saktë**

E pasaktë

8. Shoqëritë tregtare te mëdha janë ato të cilat plotësojnë dy nga tri kriteret e përcaktuar. Njeri nga këto kritere është "numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: më i madh se 100".

E saktë

**E pasaktë**

9. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", KKRF ne kuadër të funksioneve te sajë do të hartojë dhe aprovojë Standardet e Kontabilitetit të Kosovës në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit SNK/SNRF dhe direktivat relevante të BE-së;

**E saktë**

E pasaktë

10. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", Kandidatët për kontabilist të certifikuar duhet të kenë diplomë universiteti në fushën e ekonomisë dhe biznesit, dy (2) vite përvojë pune në lëmin e kontabilitetit, të kenë marrë, dhe të kenë kaluar provimin e certifikimit për këtë qëllim.

E saktë

**E pasaktë**

11. Bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, raporti vjetor i ATK do të përfshijë edhe parashikimet e kostos së mbledhjes për secilin lloj të të ardhurave nga tatimet që janë mbledhur.

**E saktë**

E pasaktë

12. Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, tatimpaguesit kanë të drejtë të kërkojnë të çregjistrohen vetëm pasi të kenë paguar të gjitha detyrimet tatimore pavarësisht a e kanë paraqitur apo jo bilancin e mbylljes.

E saktë

**E pasaktë**

13. Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Librat dhe regjistrimet për bizneset me qarkullim vjetor mbi pesëdhjetëmijë (50.000) euro duhet të mbahen në përputhje me parimet e përgjithshme të pranueshme të kontabilitetit të Kosovës që janë plotësuar me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiare.

**E saktë**

E pasaktë

14. Bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, një tatimpagues mundet të dorëzojë një ndryshim deklarate tatimore nëse ai ose ajo më vonë zbulon gabim në deklaratën tatimore të cilën e ka dorëzuar tashmë. Afati për të dorëzuar një ndryshim deklarate është jo më vonë se gjashtë (6) vjet pas datës obligative kur deklarata është dorëzuar fillimisht.

**E saktë**

E pasaktë

15. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, në rastet kur tatimpaguesit paraqesin në ATK, kërkesë për pagesë të tatimit me marrëveshje me këste, interesi nuk do të rrjedh nga muaji që pason muajin në të cilin marrëveshja është vendosur deri sa është respektuar tërësisht.

**E saktë**

E pasaktë

16. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo shumë e tatimit e paguar mbi shumën e detyrimit tatimor, me kërkesën e tatimpaguesit do të kreditohet ndaj detyrimit aktual të tatimpaguesit për çdo detyrim tjetër tatimor dhe kontribute pensionale.

**E saktë**

E pasaktë

17. Sipas Ligjin nr .05/L-028 Për Tatimin ne te Ardhurat Personale, fitimet kapitale që rezultojnë nga shitjet e pasurive kapitale, duke përfshirë pasurinë e tundshme, të patundshme dhe letrat me vlerë nuk konsiderohen te ardhurat te tatueshme.

E saktë

**E pasaktë**

18. Sipas Ligjin Nr. 05/L-028 Për Tatimin ne te Ardhurat Personale, rrogat e përfaqësuesve dhe zyrtarëve të jashtëm si dhe punonjësve të jashtëm të organizatave ndërkombëtare qeveritare dhe organizatave joqeveritare ndërkombëtare që janë regjistruar në përputhje me legjislacionin në fuqi në Kosovë dhe kanë marrë dhe mbajtur statusin e përfitimit publik sipas legjislacionit të tillë janë të ardhurat që përjashtohen;

E saktë

E pasaktë

19. Sipas ligjit nr.05/L-028 Për Tatimin ne te Ardhurat Personale, të ardhurat bruto nga interesi nuk përfshijnë interesin nga mjetet e Fondit të Kursimeve Pensionale në Kosovë apo nga cilido fond tjetër pensional i përkufizuar sipas legjislacionit përkatës mbi kursimet pensionale në Kosovë.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas ligjit nr.05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, nuk lejohet zbritje për ndonjë shpenzim të rrjedhur që lidhet me të ardhurat të cilat i nënshtrohen mbajtjes në burim, pagave, dividendëve, interesit, të drejtave pronësore, qirave, fitoreve në lotari, veç nëse janë paguar më apo para 31 marsit të periudhës tatimore vijuese.

E saktë

E pasaktë

21. Sipas ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, tatimpagues janë edhe organizatë e regjistruar si organizatë jo qeveritare sipas legjislacionit përkatës që rregullon regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve në Kosovë.

E saktë

E pasaktë

22. Sipas ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, objekti i tatimit për tatimpaguesin jo rezident janë të ardhurat e tatueshme me burim në Kosovë.

**E saktë**

E pasaktë

23. Sipas ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, humbja tatimore nga transaksionet ndërmjet personave të lidhur mund të zbritet.

E saktë

**E pasaktë**

24. Sipas Ligjit te nr . 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, Nëse një institucion financiar është i angazhuar edhe në aktivitete bankare edhe në ato të sigurimit, shpenzimet për fondin rezervë janë të lejueshme vetëm në raport me mjetet e dyshimta që dalin nga aktivitetet bankar

**E saktë**

E pasaktë

25. Sipas Ligjit te nr . 03/L-162 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave shuma e humbjes tatimore e përcaktuar sipas këtij neni, mund të bartet deri në gjashtë (6) vite të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

**E saktë**

E pasaktë

26. Sipas Ligjit te nr . 03/L-162 Për Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave , ofrimin e ndonjë Shërbimi të kryera në Kosovë nga personi jo resident për një periudhë apo periudha gjithsejtë nëntëdhjetë (90) ditore brenda një periudhe dymbëdhjetë (12) mujore nuk ka obligim për të krijuar ndërmarrje të përhershme ne Kosove.

**E saktë**

E pasaktë

27. Sipas ligjit të TVSh-së, nuk konsiderohet person i tatueshëm çdo organizatë jofitimprurëse për pagesa të përfituara nga anëtarësia, nëse kanë të tilla ose fonde,

grante, donacione të përfituara për qëllime të veprimtarisë jo-fitimprurëse të organizatës, në përputhje me Ligjin përkatës për organizatat jo-fitimprurëse, përveç kur kjo organizatë përfiton pagesa si rezultat i veprimtarisë ekonomike.

**E saktë**

E pasaktë

28. Sipas ligjit të TVSh-së Autoritetet e nivelit qendror dhe lokal dhe organet tjera të rregulluara me ligj, duhet të konsiderohen si persona të tatueshëm në lidhje me aktivitetet ose transaksionet, në të cilat angazhohen si autoritete publike edhe atëherë kur mbledhin tagra, taksa, kontribute ose pagesa në lidhje me ato aktivitete ose me ato transaksione

E saktë

**E pasaktë**

29. Sipas ligjit të TVSH, çdo person është i obliguar që të regjistrohet për TVSH nga momenti i kalimit të qarkullimit prej tridhjetëmijë euro (30.000€), brenda vitit kalendarik dhe duhet të njoftojë ATK-në brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike prej momentit kur ka lindur obligimi për regjistrim

E saktë

**E pasaktë**

30. Sipas ligjit të TVSH-se, vendi i furnizimit të shërbimeve për personin e tatueshëm, duhet të jetë vendi ku ky pranues e ka themeluar biznesin e tij

**E saktë**

E pasaktë

31. Sipas ligjit të TVSH-se, vendi i furnizimit të transportit të pasagjerëve është vendi i nisjes së transportit.

**E saktë**

E pasaktë

32. Sipas ligjit të TVSH-së, tek kontratat afatgjate në rastet kur gjatë vitit janë lëshuar një apo më shumë situacione, në fund të vitit kërkohet që të lëshohet një situacion i cili do të bazohet në matjen reale të punëve të kryera.

**E saktë**

E pasaktë

33. Sipas ligjit të TVSH-së, TVSH-ja ngarkohet sipas Normës e lart 21%; normës standarde 18% dhe normës së reduktuar 8%.

E saktë

**E pasaktë**

34. Sipas ligjit të TVSH-së, furnizimi i shërbimeve të caktuara të lidhura ngushtë me edukimin sportiv dhe fizik nga organizatat jo-fitimprurëse për personat që marrin pjesë në edukimin sportiv dhe fizik, ku qëllimi i këtyre shërbimeve është direkt i nevojshëm për atë edukim janë të liruar nga TVSH-ja.

**E saktë**

E pasaktë

35. Sipas ligjit të TVSH-së, personi i tatueshëm mund të kërkojë rimbursimin e TVSH-së nëse për tre (3) muaj radhazi është në kreditim dhe në fund të muajit të tretë shumën e kreditimit të TVSH-së kalon vlerën prej tremijë euro (3000 €), si dhe nëse janë dorëzuar të gjitha deklaratat e TVSH-së dhe tatimeve tjera për të gjitha periudhat tatimore të kaluara.

**E saktë**

E pasaktë

36. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës bën miratimin e parimeve të investimeve për Fondin;

**E saktë**

E pasaktë

37. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, në rastet kur rrogat për orar të plotë, qoftë të paguara në natyrë ose ndryshe, janë më të vogla se Paga maksimale, punëdhënësi i paguan pesë përqind (5%) të rrogës maksimale dhe punonjësi paguan pesë përqind (5%) të rrogës së tij ose të saj për orar të plotë pune.

E saktë

**E pasaktë**

38. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, fondi në intervale të rregullta dhe së paku një herë në çdo dymbëdhjetë (12) muaj e informon çdo pjesëmarrës me shkrim për



mjetet në llogarinë individuale të pjesëmarrësit, me datat e kontributeve dhe shumat e fitimit nga investimi

**E saktë**

E pasaktë

39. Fondi pensional mund të investohet në instrumentet e letrave me vlerë që nuk janë të regjistruara ose publikisht që nuk janë të tregtuara;

E saktë

**E pasaktë**

40. Njeri nga llojet e pensioneve që ofrojnë kompanitë e sigurimeve të licencuara është: pensionin e veçantë jetësor të garantuar për periudhën prej së paku pesë (5) vjet në bazë të të cilit, nëse pjesëmarrësi vdes gjatë periudhës së garancisë, shumat e papaguara që do t'i ishin paguar pjesëmarrësit për atë periudhë do t'iu paguhen përfituesve të caktuar nga pjesëmarrësi

**E saktë**

E pasaktë

41. Sipas Ligjit të Punës, dispozitat e Kontratës Kolektive, Aktit të Brendshëm të Punëdhënësit dhe Kontratës së Punës duhet të jenë në përputhje me dispozitat e këtij ligji

**E saktë**

E pasaktë

42. Sipas Ligjit të Punës, nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kriterëve të caktuara që kërkohen për atë vend pune.

**E saktë**

E pasaktë

43. Sipas Ligjit të Punës, asnjë punëdhënës nuk mund të lidhë kontratë pune me ndonjë person nën moshën tetëmbëdhjetë (18) vjeç.

E saktë  
E pasaktë

44. Sipas Ligjit të Punës, kontrata për një detyrë specifike, nuk mund të jetë më e gjatë se njëqindnjëzet (120) ditë brenda një (1) viti.

E saktë  
E pasaktë

45. Sipas Ligjit të Punës, puna Provuere mund të zgjasë, më së shumti gjashtë (6) muaj në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive dhe Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit.

E saktë  
E pasaktë

## Pjesa B. Pyetjet problemore

### Problemi 1

15 pikë

Më poshtë është dhënë bilanci vërtetues i kompanisë së sigurimit fizik BB Sh.p.k 31. 12. 2016.

	<u>Debi</u>	<u>Kredi</u>
Banka	137,500	
Arka	330	
Llogarit e arkëtushme	325,353	
Parapagimet	122,623	
Stoku	230,000	
Kamion dhe vetura	180,000	
Zhvlerësimi I grumbulluar për kamion dhe vetura		32,400
Pajisje	24,500	
Zhvlerësimi i grumbulluar për pajisje		6,125
Makineri e rënd	550,000	
Zhvlerësimi i grumbulluar		66,000
Llogarit e pagueshme		109,161
Tatimi ne burim		1,080
Akrualet		30,350
Kapitali themelor		330,000
Obligimi për Pensione		1,338
Obligimi për TAP		920
Pagat neto		11,791
TVSH	3,200	
Obligim ndaj kredisë		87,627
Te ardhurat		2,953,421
KMSH	1,120,901	
Shpenzimet e komunikimit	28,051	
Rryma	83,080	
Pensionet	8,028	
Shpenzimet mjekësore	532	
Sh. Bankare	3,916	

Zhvlerësimi	104,525	
Provizionet për Llog. Arktu.	9,761	
Sigurimi	496	
Sh. Interesit	15,515	
Donacion	150,000	
Shpenzimet e karburantit	116,023	
Shpenzime zyre	21,264	
Pagat	160,556	
Sh. profesionale	17,060	
Qiraja	144,000	
Shpenzime marketing	25,000	
Shpenzimet e përfaqësimit	48,000	
		<hr/>
<b>TOTAL</b>	<b>3,630,213</b>	<b>3,630,213</b>
		<hr/> <hr/>

**Informacion shtesë:**

1. Kompania ka filluar aktivitet në këtë vit
2. Makineria e rendë i takon grupit të tret të aseteve, është importuar nga Gjermania.
3. Interesi është vetëm i përlogaritur, pagesa do të fillon pas dy viteve sipas marrëveshjes.
4. Provizioni për llogarit e arkëtueshme është vendim i menaxhmentit.
5. Qiraja dhe pagat e muajit 12 do të paguhet në Maj të vitit 2017. Nuk ka pas ndryshim të qirasë dhe pagave nga Janari deri në Dhjetore.
6. Te rishikohet çdo shpenzim i limituar sipas Ligjit "Për tatimi në të ardhurat e korporatave"

**Kërkohet:**

Llogaritni fitimin para tatimit kontabël të kompanisë?  
Llogaritni obligimin tatimor pas rregullimeve të nevojshme bazuar në Ligjin mbi të ardhurat e korporatave?.

## Zgjidhje

Te ardhurat	2,953,421
KMSH	(1,120,901)
<hr/>	
Fitimi Bruto	1,832,520
SHP	(935,806)
<hr/>	
FIT Kont. Para Tatim	896,714
Rregullimet:	
Zbritje e veçantë(2*)	(55,000)
Interesi (3*)	15,515
Provizioni(4*)	9,761
Qiraja dhe Pagat(5*)	26,049
Shpenz.perfaqesimit(6*)	18,466
Zhvlerësimi (7*)	8,625
Donacioni	150,000
<hr/>	
Fitimi para donacionit	<b>1,070,130</b>
Donacioni (7*)	<b>107,013</b>
<hr/>	
Fitimi par tatimit	<b>963,117</b>
Tatimi (10%)	<b>96,312</b>
<hr/> <hr/>	

2\* Zbritja e veçantë për makinerinë e rëndë sipas Ligjit Per Tatimin ne te Ardhurat e Korporatave ne 17 pika 1 prej 10%.  $550,000 \times 10\% = 55,000$  shpz.

3\* Interesi i pa paguar nuk njihet si shpenzim ne atë periudhe.

4\*Provizioni nuk pranohet shpenzim i vitit sipas TAK.

5\* Qiraja dhe pagat e Dhjetorit nuk pranohen shpenzim për këtë periudhe pasi qe nuk do te paguhen deri me 31 Mars te vitit ne vijim.

Qiraja -  $144,000/12 = 12,000$

Paga -  $160,556/12 = 13,380$

Pensioni  $8,028/12 = 669$

**Total** **26,049**

6\* Shpenzimet e përfaqësimit te kufizuara ne 1% te shitjeve

$2,953,421 \times 1\% = 29,534$  shpenz te lejuara

Shpenzime te ndodhura 48,000-  $29,534 = 18,466$  (shpz te pazbritshme)

7\* Zhvleresimi

Grupi II

Kamiona dhe vetura  $180,000 \times 20\% = 36,000 - 32,440$  (kont) = 3,600 - rritje zhvlerësimit

Paisje  $24,500 \times 20\% = 4,900 - 6,125$  (kont) = 1,225 - zvogëlim zhvlerësimit

Grupi III

Makineria e rëndë  $550,000 \times 10\% = 55,000 - 66,000$  (kont) = (11,000) - zvogëlim zhvlerësimit

**TOTAL shpenzim i pazbritshem 8,625**

8\* Donacioni i lejuar vetëm 10% e fitimit para donacioni

## Problemi 2

5 pikë

Znj. Elisa ne cilësinë e Inxhinieres është punësuar në kompaninë INGENERING me datë 01.07.2016, paga mujore është 1,800 Eur dhe një bonus në Dhjetor prej 10% e te ardhurës te këtij viti.

Kërkohe:

Llogaritni detyrimin e tatimit dhe kontributin pensional të ndalur në burim dhe i paguar nga kompania INGENERING për Znj. Elisa?

Llogarit detyrimet tatimore për deklaratën përfundimtare te Znj. Elisa?

Cila është diferenca ne mes te tatimit te paguar dhe detyrimit për tu paguar?

### Zgjidhje

Pagesat mujore

Paga bruto 1,800

Pensionet  $1,800 \times 5\% = 90 + 90 = 180$

TAP

$1,800 - 90 = 1,710$ (baza për tatimi)

0-80 = 0

$80 - 250 = 4\% - 170 \times 4\% = 6.80$

$250 - 450 = 8\% - 200 \times 8\% = 16.00$

$450 - 1710 = 10\% - 1260 \times 10\% = 126.00$

**TOTAL Mujor 148.80**

Bonusi  $1,800 \times 6$  ( muaj)  $= 10800 \times 10\% = 1,080$

KP për bonus  $1080 \times 5\% = 54 + 54 = 108$

TAP për bonus  $1,080 - 54 = 1,026$ ( baza e tatimit)

$1,026 \times 10\% = 102.60$

Pagesat nga INGENERING për Znj. Elisa

**KP**

$180 \times 6$  muaj  $= 1,080$

Për bonus 108

**TOTAL 1,188**

**TAP**

$148.80 \times 6$  muaj  $= 892.80$

Për bonus = 102.60

**TOTAL 995.40**

## Deklarata vjetore

Te ardhurat e tatueshme	
Te ardhurat e mujore	$1,710 \times 6 = 10,260$
Bonusi vjetor i tatueshem	<u>1,026</u>
<b>TOTALI</b>	<b>11,286</b>

0 - 960 = 0

960 - 3000 = 4% -  $2040 \times 4\% = 81.60$

3000 - 5400 = 8% -  $2400 \times 8\% = 192.00$

5400 - 11,286 = 10% -  $5886 \times 10\% = 588.60$

Obligimi për TAP 862.20

Paguar (995.40)

Rimbursim -133.20



**Problemi 3****5 pikë**

Kompania " XIX" për vitin që përfundon me 31.12.2016 kishte ketë përbërje të fitimit para tatimit:

1. Fitimi nga aktiviteti	130,000
2. Dividende	20,000
3. Te ardhura nga shitja e asetëve	3,000
4. Kompensim i sigurimit	2,500
<b>Total</b>	<b>155,500</b>

Sqarim: Te ardhurat nga shitja e asetëve ka të bëjë me shitjen e një kamjonete të blere në vitin 2009, i takonte grupit të dytë të aseteve.

**Kërkohe:**

Llogarit tatimin në fitim të kompanisë " XIX " për te ardhurat e tatueshme sipas Ligjit Për Tatimin në te ardhurat e Korporatave për vitin 2016.

**Zgjidhje**

1. Fitimi nga aktiviteti	$130,000 \times 10\% = 13,000$
2. Dividende	20,000 ( e ardhure e përjashtuar)
3. Te ardhura nga shitja e asetëve	3,000 ( e ardhur e përjashtuar)
4. Kompensim i sigurimit	2,500 ( e ardhur e përjashtuar)
<b>Obligimi tatimor</b>	<b>13,000</b>

#### Problemi 4

10 pikë

“Gama” SH.P.K regjistroi blerje gjatë Dhjetorit/2016 në shumën Eur 10,000 me normën standarde; blerje ne shumën 5,000 EUR me normën e reduktuar; shitjet vendore në këtë muaj Eur 20,000 me normën standarde dhe 3,000 EUR me normën e reduktuar (Vlerat e paraqitura janë pa përfshirë TVSH-në).

Ne muajin Dhjetor 2016 “Gama” SH.P.K ka lëshuar një Notë Krediti për një blerës për shitje ne muajin Korrik 2016, vlera e TVSH-së në këtë note Krediti është Eur 530 (me normë standarde). Po në këtë muaj kompania pranoj një Notë Krediti nga një furnitor për blerjet e muajit Qershor 2016, vlera e TVSH-së në këtë notë Krediti është Eur 230 (me norme standarde). Gjithashtu në këtë muaj Gama gjeti një faturë të muajit Tetor 2015 qe për shkaqe teknike nuk ishte regjistruar ne librat e blerjes. Vlera e kësaj fature ishte 8,500 Eur +TVSH ( me normën standarde).

#### Kërkohet:

A ka detyrim të TVSH-se për te paguar ne këtë muaj “Gama” SH.P.K”, nëse po sa është obligimi ? Plotëso deklaratën tatimore.

#### Zgjidhje

##### Libri i shitjeve

Shitjet me norme te reduktuar	3,000 x 8%	=	240
Shitjet me norme standarde	20,000 x 18%	=	3,600
<u>Note Krediti e pranuar</u>	<u>1,278 x 18%</u>	=	<u>230</u>
TOTAL TVSH e llogaritur			4,070

##### Libri i blerjeve

Blerjet me normën e reduktuar	5,000 x 8%	=	400
1*Blerjet me normën standarde	18,500 x 18%	=	3,330
<u>Note Krediti e lëshuar</u>	<u>2,944 x 18%</u>	=	<u>530</u>
TOTAL TVSH e zbritshme			4,260

TVSH e pagueshme = TVSH e llogaritur - TVSH e zbritshme - Kreditimi i bartur

TVSH e pagueshme = 4.070 - 4,260

= -190 ( mbete ne kreditim)

1\* Blerjet 10,000 +8,500 (fatura e vjetër)= 18,500. Sipas Ligjit te TVSH një faturë mund te regjistrohet deri ne Dhjetor te vitit ne vijim Neni 38 pika 2.

**Problemi 5****5 pikë**

Kompania Dante SH. A me date 31.12.2016 kishte këtë gjendje të aseteve sipas kontabilitetit:

Vlera	Shkalla e zhvlerësimit
Sipas grupit	sipas kontabilitetit
Grupi I - 250,500	4%
Grupi II - 90,000	16%
Grupi III - 350,000	12%
Grupi (1000-3000) -12,200	20%

**Kërkohet:**

Te llogaritet zhvlerësimi sipas kontabilitetit dhe sipas Ligjit Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave dhe njëherit të gjendet diferenca e zhvlerësimit për secilin grup.

**Zgjidhje**

	Sipas kontabilitetit a	Sipas Tatimeve b	Diferenca c=a-b
Grupi I	$250,500 \times 4\% = 10,020$	$250,500 \times 5\% = 12,525$	(2,505)
Grupi II	$90,000 \times 16\% = 14,400$	$90,000 \times 20\% = 18,000$	(3,600)
Grupi III	$350,000 \times 12\% = 42,000$	$350,000 \times 10\% = 35,000$	7,000
Grupi (1000-3000)	$12,200 \times 20\% = 2,440$	$12,200 \times 20\% = 2,440$	0
<b>Shpenzimet e zhvlerësimit me të larta në kontabilitet për vlerën</b>			<b>895</b>

## Problemi 6

5 pikë

Prishtina sh.p.k. për periudhën 08/2016 ne baze te regjistrimeve ne librat e TVSH kishte obligim për pagese ne vlere prej 4,800 Eur. Kompania deklaroi obligimin me datë 22.09.2016 dhe pagoi me datë 05.10.2016.

### Kërkohet:

Sa janë gjobat dhe interesi për vonese pagesat që kompania duhet paguar duke u bazuar ne kalkulimet dhe lehtësimet që parasheh Ligji mbi Procedurat dhe Administratën Tatimore ?

### Zgjidhje

1* Gjoba për mos deklarim në kohe	$4,800 \times 5\% = 240 \times 25\% = 60.00$
2* Gjoba për mos pagese në kohe	$4,800 \times 1\% = 48 \times 25\% = 12.00$
3* <u>Interesi</u>	$4,800 \times 1.4\% = 67.20$
<b>TOTALI</b>	<b>139.20</b>

1\* Neni 51 pika 1 i ligjit Proc. ATK për mos deklarim te tatimit ne kohe ndëshkim 5% për muaj max 5 muaj. Ne rastin konkret kemi te bëjmë me 1 muaj vonese.

2\* Neni 51 pika 2 i ligjit Proc. ATK për mos pagese tatimit ne kohe ndëshkim 1% për muaj max 12 muaj. Ne rastin konkret kemi te bëjmë me 1 muaj.

3\* Neni 28 pika 1 i ligjit Proc. ATK-se, deri ne ditën e pageses se tatimit llogaritet interes 0.70% ne muaj. Ne rastin konkret ne kemi te bëjmë me 2 muaj mos pagese te tatimit.

4\* Neni 62 pika 1 i ligjit Proc. ATK-se, Në rastin kur tatimpaguesi i cili i nënshtrohet një ose më tepër sanksioneve të parashikuara në nenet 50 deri 61 të këtij ligji, vullnetarisht informon ATK për detyrimin e tij, përpara se së pari të jetë njoftuar për një inspektim tatimor të mundshëm nga ATK, i cili do të mund zbulohet nga ATK, sanksioni maksimal financiar i mundshëm do të jetë njëzetepesë përqind (25%) i sanksionit që do të zbatohet përndryshe.

## Problemi 7

10 pikë

Koeficienti i TVSH-se se zbritshëm për vitin 2015 për kompaninë “TMT GROUP” ishte 70%.

Totali i blerjeve gjate vitit 2016 ishte 1,600,000 EUR (norma standarde) dhe 200,000 EUR (norma e reduktuar); shitje vendore 2,700,000; eksport 600,000 EUR dhe shitje te përjashtuara pa te drejte kreditimi Eur 2,200,000.

### Kërkohet:

- Sa është koeficienti i TVSH-se se zbritshem për vitin 2016?
- Sa është rregullimi i TVSH-se ne deklaraten e Dhjetorit 2016 ?
- Tregoni se a do te ketë rritje apo zvogëlim pagese te TVSH-se pas rregullimit?

### Zgjidhje

a).

$$PZ = \frac{\text{Furnizimet e tatueshme + eksporte}}{\text{Furnizimet e tatueshme + eksporti + Furnizimet e përjashtuara}} \times 100$$

$$PZ = \frac{2,700,000 + 600,000}{2,700,000 + 600,000 + 2,200,000} \times 100 = 60\%$$

b).

NS-  $1,600,000 \times 18\% = 288,000 \times 70\% = 201,600$  (TVSH e shfrytëzuar gjate vitit)

NS-  $1,600,000 \times 18\% = 288,000 \times 60\% = 172,800$  (TVSH sipas koeficientit real)

**Diferenca për rregullim 28,800**

NR-  $200,000 \times 8\% = 16,000 \times 70\% = 11,200$  (TVSH e shfrytëzuar gjate vitit)

NR-  $200,000 \times 8\% = 16,000 \times 60\% = 9,600$  (TVSH sipas koeficienti real)

**Diferenca për rregullim 1,600**

c). Gjate viti 206 PZ e përdorur 70%

Përfundimtarja 60%

Diferenca 10 % shfrytëzim me i larte i TVSH-së së zbritshme

**Për pagesë shtesë të TVSH-se:** NS - 28,800

NR - 1,600

**Totali i pagesës 30,400**